

Informohu dhe përfito nga ligji!

Gëzo të drejtat ligjore dhe mbro jetën tënde!



Ofrohet Këshillim dhe Ndihmë Juridike Falas në Pogradec

Përgatitja e kësaj fletëpalosje u mundësua si pjesë e projektit “Zgjerimi i Shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas për Gratë dhe Burrat në Shqipëri” financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe zbatuar nga UNDP në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë.

Me ndihmë juridike kuptojmë ofrimin e shërbimit ligjor falas për individët që janë në pamundësi financiare për të paguar një avokat.

Ligji Nr 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” sanksionon që ky shërbim ofrohet falas.

Ligji “Për ndihmën juridike” ka për qëllim të përcaktojë kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për ofrimin e kësaj ndihme, si dhe institucionet publike përgjegjëse që marrin kompetenca për ofrimin e ndihmës ligjore falas me fonde të shtetit.

Ndihma juridike, sipas kuptimit të ligjit, ndahet në dy kategori

Ndihma juridike parësore: është dhënia e informacionit lidhur me sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave nga individë ose grupe individësh, gjatë procesit gjyqësor dhe atyre jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumentave juridike, që shërbejnë në proceset e sipërshënuara, apo në forma të tjera.

Ndihma juridike dytësore: është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile dhe administrative, si dhe të paraqitjes para organeve administrative shtetërore. Kjo ndihmë mund të jepet vetëm nga personat që ushtrojnë profesionin e avokatit, duke qenë anëtarë të Dhomës së Avokatisë dhe të licencuar për këtë qëllim.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, pas miratimit të kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike dytësore falas në bashkëpunim me Dhomën e Avokatisë publikon listën e avokatëve, të cilët ofrojnë këtë shërbim.

Në qytetin e Pogradecit tashmë janë tre avokatë që mund t'ju vijnë në ndihmë.



Kush janë personat që mund të përfitojnë ndihmë juridike falas sipas ligjit?

-Të papunët;

-Familje të tjera që jetojnë në varfëri (pavarësisht se ndonjë pjesëtar i familjes është në punë familja jeton në nivelin e varfërisë);

-Të moshuar pa të ardhura të mjaftueshme;

-Pensionistët (përfshirë ata që përfitojnë pensione suplementare ose pensione të posaçme);

-Gratë kryefamiljare pa të ardhura, ose gratë viktime të dhunës në familje;

-Fëmijët e braktisur dhe jetimët;

-Fëmijë të familjeve të varfëra;

-Personat me aftësi të kufizuar që nuk janë në marrëdhënie pune;

-Anëtarët e komuniteteve vulnerabël si ata Romë dhe Egjyptianë;

-Individë vulnerabël që vuajnë dënimin në institucionet e paraburgimit dhe të burgimit në Shqipëri, azilkërkues etj.

Kategoritë e personave më sipër:



a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësisve financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të;

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës;

c) të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.

Si mund të kërkohet ndihma juridike falas?

Ndihmën juridike parësore mund ta përfitoni duke u drejtuar në Zyrën e Ndhmës Juridike Parësore në Pogradec. Këtu mund të merrni informacion, këshillim, të ndihmoheni në hartimin dhe përpilimin e dokumentave, etj.

Shoqata “Unë, Gruaja” ofron shërbimin e ndihmës juridike parësore falas për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje.

Tel: 083222140





Nëse kërkohet të përfitohet ndihmë juridike dytësore në formën e përfaqësimit në gjykatë për një çështje:

a-civile,

b-penale ose

c-administrative,

shtetasi duhet të paraqesë formularin tip të kërkesës, personalisht apo nga përfaqësuesi i tij i autorizuar me prokurë, pranë organeve përkatëse sikurse përcakton ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

KUJDES: Në rast se personi do që ta përfitojë ndihmën juridike dytësore falas, duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet sipas ligjit për ta përfituar atë.

Kërkesa dhe formulari tip që plotësohet nga subjekti i interesuar apo përfaqësuesi i tij ligjor shoqërohet me dokumentat justifikues pranë organit përkatës, i cili vendos pranimin ose refuzimin e kësaj kërkesë.



**Informimi ligjor është i rëndësishëm
për të gjithë ne!**

Projekti:

“Ligji është jetë- Mbrojeni jetën tuaj!”

- Ky projekt po zbatohet nga shoqata “Unë, Gruaja” me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Projekti synon:

-Të rrisë plotësimin e kërkesave sociale dhe ligjore të personave në nevojë përmes edukimit ligjor për gëzimin e të drejtave të tyre dhe ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti.

-Të rrisë njohuritë mbi kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë.

-Të lehtësojë aksesin e qytetarëve në përmbushjen e të drejtave të tyre ligjore dhe të promovojë Zyrën e Ndihmës Juridike Falas.

Për më shumë informacion kontaktoni:

Zyra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas,
Adresa: Lagjia 2, Bulevardi “Reshit Çollaku”,
pranë Bibliotekës së Qytetit, Pogradec

E-mail: ndihmajuridike.pogradec@drejtësia.gov.al

Shoqata “Unë Gruaja”

Tel: 083222140 / Cel 0676470005



Shoqata Une, Gruaja



une_gruaja@yahoo.com



www.unegruaja.org.al